



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

**RREGULLORE
E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT**

Lipjan, nëntor 2008

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28 e datës 04.04.2008 dhe neneve 20 dhe 27 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, në seancën e mbajtur më datë 07.11.2008 miratoi këtë:

R R E G U L L O R E E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1 - Lënda e rregullimit

Me këtë Rregullore përcaktohet puna dhe mënyra e funksionimit të Kuvendit të Komunës së Lipjanit, si vijon:

- mbledhjet e Kuvendit,
- kuorumi për punë dhe vendosje dhe procedurat e votimit,
- aktet e Kuvendit,
- procedura e propozimit të akteve,
- të drejtat, obligimet e anëtarëve të Kuvendit dhe parashtrimi i propozimeve procedurale,
- përdorimi i gjuhëve në punën e Kuvendit,
- transparenca e punës në mbledhjet e Kuvendit,
- përcaktimi i rendit të ditës,
- puna në mbledhjet e Kuvendit,
- rendi dhe sjellja gjatë punës së Kuvendit,
- shtyrja, ndërprerja dhe përfundimi i mbledhjes së Kuvendit,
- përgatitja dhe nënshkrimi i akteve të miratuara nga Kuvendi, dhe
- publikimi i akteve të miratuara nga Kuvendi.

II. MBLEDHJET E KUVENDIT

Neni 2 - Mbledhja inauguruese

2.1 Kuvendi i komunës e mban mbledhjen inauguruese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

2.2 Mbledhja inauguruese e Kuvendit të komunës thirret nga kryetari (aty ku është i zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

2.3 Nëse Kryetari i Kuvendit të Komunës nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit të komunës mund të thirret nga anëtar i më i vjetër i zgjedhur i kuvendit komunal, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kryetari është dashur të thirrë mbledhjen inauguruese të Kuvendit të komunës.

(15) ditësh nga data kur kryetari është dashur të thirrë mbledhjen inauguruese të Kuvendit të komunës.

2.4 Nëse anëtari më i vjetër i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit të komunës mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të komunës.

2.5 Mbledhjet e Kuvendit të komunës që mbahen para zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit të komunës kryesohen nga anëtari më i moshuar i Kuvendit të komunës që është i pranishëm në mbledhje.

Neni 3 - Mbledhjet e rregullta

3.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitave tjera ligjore dhe Statutin e Komunës, mbanë së paku 10 mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.

3.2 Kuvendi i Komunës, sipas nevojës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik

Neni 4 - Mbledhjet e jashtëzakonshme

4.1 Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të komunës, apo me kërkesë të Kryetarit të Komunës.

4.2 E drejta për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës.

4.3. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

4.4 Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të komunës, nuk do të mbahet nëse të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.

4.5 Procedurat të cilat kërkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, gjithashtu zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme.

Neni 5 - Mbledhjet urgjente

5.1 Mbledhjet urgjente të Kuvendit të komunës caktohen në rastet e situatave urgjente, fatkeqësive elementare dhe gjendjeve tjera emergjente.

5.2 Procedurat të cilat kërkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, nuk zbatohen për mbledhjet urgjente.

Neni 6 – Mbledhjet Solemne

Përveq mbledhjes inauguruese, mbledhjeve të rregullta, të jashtëzakonshme, urgjente, Kuvendi i komunës mund të mbaj edhe mbledhje solemne.

Neni 7 - Thirrja dhe kryesimi i mbledhjeve të Kuvendit

Kryesuesi i Kuvendit të komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të komunës të përcaktuara në nenet 3,4 dhe 5 të kësaj Rregulloreje.

Neni 8 - Njoftimet për mbajtjen e mbledhjeve

8.1 Të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me ftesë me shkrim, shtatë (7) ditë pune para datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes. Ftesës i bashkëngjiten materialet sipas pikave të propozuara të rendit të ditës.

8.2 Për mbajtjen e mbledhjes duhet të njoftohet publiku, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe përfaqësuesit e mediave.

8.3 Njoftimi për mbajtjen e mbledhjeve duhet të përmbajë:

- a) datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes; dhe
- b) rendin e ditës për mbledhje.

8.4 Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin mbi Gjyhet.

8.5 Njoftimi i publikut për mbajtjen e mbledhjeve do të bëhet në Webfaqen e Komunës, Tabelën e shpalljeve, mediat elektronike dhe në vendet më të frekventuara në vendbanimet e Komunës.

III. KUORUMI PËR PUNË DHE VENDOSJE DHE PROCEDURAT E VOTIMIT

Neni 9 - Kuorumi

9.1 Kuorumi i nevojshëm për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës do të egzistojë kur në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e përberjes së Kuvendit.

9.2 Kuorumi duhet të verifikohet para fillimit të mbledhjes së Kuvendit dhe para procedurës së votimit për marrjen e vendimeve.

9.3 Kuorumi i nevojshëm për vendosje egziston kur në mbledhje janë të pranishëm anëtarët e Kuvendit me votat e të cilëve sipas procedurës së përcaktuar mund të merret vendimi përkatës.

Neni 10 - Procedurat e votimit

10.1 Në mbledhjet e Kuvendit të komunës për marrjen e vendimeve për çështjet e caktuara, votohet me vota të hapura, ndërsa me votim të fsheftë në rastet e parapara me ligj.

10.2 Anëtarët e Kuvendit sipas propozimeve për marrjen e vendimeve për çështjet e caktuara, sipas parashtrimit në procedurë të propozimit nga Kryesuesi i Kuvendit, votojnë me vota të hapura me ngritjen e dorës, “për” propozimin ose “kundër” propozimit, përkatësisht mund të abstenojnë në procedurën e votimit.

10.3 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të komunës anëtarët e Kuvendit, përfshirë edhe kryesuesin, gjatë procedurës së votimit ka nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.

10.4 Nëse ndryshe nuk parashihet me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, vendimet e Kuvendit të komunës aprovohen me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.

10.5 Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

IV. AKTET E KUVENDIT

Neni 11 – Llojet e akteve

11.1 Të gjitha aktet e Kuvendit të Komunës duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

11.2 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitave tjera ligjore dhe Statutin e Komunës, miraton:

- a) Rregullore,
- b) Vendime,
- c) Aktvendime,
- d) Konkludime dhe akte tjera nga kompetenca.

Neni 12 – Çështjet e rregullimit të akteve

12.1 Me Rregullore, Kuvendi i Komunës vendos përkitazi me çështjet e lëmive përkatëse nga kompetenca vetanake si dhe për obligimet e komunës të përcaktuara me dispozita ligjore, të cilat e obligojnë komunën për rregullimin e çështjeve të caktuara me rregullore përkatëse.

12.2 Me Vendim, Kuvendi i Komunës vendos përkitazi me çështjen përkatëse nga kompetenca vetanake, për zbatimin e diskutimit publik për rregulloret dhe aktet e caktuara, për delegimin e kompetencave vetanake, si dhe për obligimet e komunës të përcaktuara me dispozitat ligjore të cilat e obligojnë komunën dhe parashohin që çështja e caktuar të rregullohet me vendim.

12.3 Me Aktvendim, Kuvendi i Komunës vendos përkitazi me çështjen e emërimeve të anëtarëve të komiteteve të Kuvendit, komisioneve dhe trupave tjerë të punës.

12.4 Me Konkludim, Kuvendi i Komunës përcakton obligimet e Ekzekutivit të Komunës dhe Administratës komunale për përgatitjen e materialeve të caktuara për shqyrtim në mbledhjet e Kuvendit, vendos për refuzimin e aprovimit të akteve të caktuara, për kthimin e materialeve në përmirësim dhe përpunim të mëtejshëm.

V. PROCEDURA E PROPOZIMIT TË AKTEVE

Neni 13 - Propozimi i akteve

13.1 Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës miratimin e akteve sipas procedurave të përcaktuara me dispozita ligjore dhe me Statutin e Komunës.

13.2 Projektet dhe propozimet e akteve për miratim duhet të jenë të bazuara në dispozita ligjore, Statutin e Komunës dhe të përmbajnë pjesën e arsyetimit me shkrim mbi bazën juridike dhe arsyeshmërinë ekonomike si dhe arsytet tjera për miratimin e aktit përkatës.

13.3 Materialet e përgatitura për shqyrtim, paraprakishtë do të shqyrtohen në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës, në pajtim me fushëveprimin dhe kompetencën që kanë komitetet e Kuvendit sipas dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe dispozitat e Statutit të Komunës.

13.4 Projektet dhe propozimet e akteve për miratim në ekzemplarë të mjaftueshëm, para përcaktimit të Rendit të ditës, i dërgohen Drejtoratit për Administratë – Sektorit për punë të Kuvendit.

VI. TË DREJTAT, OBLIGIMET E ANËTARËVE TË KUVENDIT DHE PARASHTRIMI I PROPOZIMEVE PROCEDURALE

Neni 14 - Të drejtat e anëtarëve të Kuvendit të komunës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta, si vijon :

- a) të marrin pjesë plotësisht në punimet e Kuvendit;
- b) të kërkojnë shtimin e një pikë në rendin e ditës gjatë mbledhjes së regullt të Kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike;
- c) të diskutojnë në mbledhjet e Kuvendit;
- g) sipas procedurës së përcaktuar me këtë Rregullore, të parashtrojnë amandamente në projektet e akteve të cilat shqyrtohen në Kuvend;

- e) të kërkojnë nga Kryetari i Komunës dhe drejtorët e organeve të Administratës Komunale, informacione me gojë dhe me shkrim lidhur me çështjet komunale, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Statut dhe këtë Rregullore;
- d) të dorëzojnë vërejtje me shkrim, të cilat i bashkëngjiten procesverbalit;
- f) t'iu drejtohen të pranishmëve në cilindo komision të Kuvendit të komunës anëtar i të cilit nuk janë, por nuk mund të votojnë;
- g) t'i propozojnë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit;
- h) të mungojnë nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen punëve të Kuvendit;
- i) të realizojnë kompenzim për punën në Kuvendin e komunës.

Neni 15 - Obligimet e anëtarëve të Kuvendit të komunës

15.1 Anëtarët e Kuvendit të komunës duhet të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur në komisionet ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre.

15.2. Çdo anëtarë duhet të angazhohet të marrë pjesë aktivisht në mbledhjet e Kuvendit të Komunës duke u përgatitur për mbledhje dhe duke parashtruar mendimin e vetë lidhur me çështjet që janë në rend të ditës. Po ashtu çdo anëtarë duhet që gjithëherë të njoftojë Kryesuesin e Kuvendit të Komunës për pamundësinë e ardhjes së tij në mbledhje dhe arsyet për mungesën e tij konstatohen në procesverbal.

Neni 16 - Propozimet procedurale

16.1 Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, kryetarët e grupeve parlamentare ose anëtarët, mund të propozojnë cilëndo nga propozimet në vijim:

- a) Propozimi për të shtyrë mbledhjen e Kuvendit;
- b) Propozimi për të shtyrë debatin për ndonjë pikë të rendit të ditës.
- c) Propozimi për plotësimin e rendit të ditës,
- d) Propozimi për të deleguar në kompetencë për vendosje të ndonjë çështjeje ndonjë komiteti apo komisioni të Kuvendit, dhe
- e) Propozimi për të përfunduar debatin sipas pikës të rendit të ditës.

16.2. Lidhur me propozimet e cekura në pikat b) dhe c), votohet pa debat.

16.3. Lidhur me propozimet sipas pikës d) Kuvendi i Komunës, duke marrë parasysh përgjegjësitë e Komunës të përcaktuara me dispozitat e nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale përkritazi me kompetencat të cilat nuk mund ti delegoj, duhet të zhvilloj debat për të arsyetuar qështjen që propozohet për delegim në kompetencë të vendosjes.

16.4. Lidhur me propozimet sipas pikës e), do të debatohet menjëherë dhe pastaj do të votohet në përputhje me këtë Rregullore.

Neni 17 – Procedura për propozimin e amandamenteve

17.1 Kryetarët e grupeve parlamentare dhe anëtarët e Kuvendit, pas marrjes së ftesës dhe materialeve për mbledhjen e Kuvendit, kanë të drejtë të parashtrojnë

amandamente duke dhënë arsyetimin me shkrim përkitazi me projektet e akteve të cilat do të shqyrtohen në Kuvend.

17.2 Amandamentet i dërgohen Kryesuesit të Kuvendit, më së voni 3 ditë para datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes.

17.3 Shërbimi për punë të Kuvendit, me kopjet e amandamenteve të pranuar do të njoftojë menjëherë parashtuesin e propozimit të aktit, ndërsa anëtarët e Kuvendit më së voni deri para fillimit të mbledhjes.

Neni 18 - Konfliktet e Interesit të anëtarëve të Kuvendit të komunës

18.1 Anëtari i Kuvendit të Komunës, gjatë punës së Kuvendit të Komunës, komiteteve të Kuvendit të Komunës, komisioneve dhe grupeve të punës të caktuara nga Kuvendi, nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij apo saj, ka interes personal dhe material.

18.2 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, gjatë punës së Kuvendit me rastin e marrjes së vendimeve do të pyesë anëtarët e Kuvendit për egzistimin eventual të konfliktit të interesit dhe do t'i njoftojë anëtarët e Kuvendit kur për egzistimin e konfliktit të interesit Kuvendi është njoftuar nga ndonjë subjekt tjetër.

18.3 Anëtari i Kuvendit të Komunës ka për obligim të tërhiqet në mënyrë vullnetare nga pjesëmarrja në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij apo saj, ka interes personal dhe material.

18.4 Nëse për ndonjë anëtarë të Kuvendit të Komunës, gjatë punës së Kuvendit të Komunës në procedurën e marrjes së vendimit për qështjen konkrete, shtrohet qështja e konfliktit të interesit të atij anëtari, Kryesuesi i Kuvendit për këtë do të hap debat duke ia dhënë fillimisht mundësin e fjalës anëtarit të Kuvendit për të cilin është shtruar qështja e egzistimit të konfliktit të interesit dhe mëpastaj edhe anëtarëve tjerë të cilët dëshirojnë të diskutojnë për këtë qështje.

18.5 Nëse faktet e prezentuara gjatë diskutimit, rezultojnë në arsyeshmërin për përjashtimin e anëtarit të Kuvendit nga procedura e marrjes së vendimit për qështjen konkrete, Kryesuesi i Kuvendit do të paraqesë propozimin për votim.

18.6 Nëse për propozimin nga paragrafi paraprak votojnë "për" më shumë se gjysma anëtarëve prezent në mbledhje, atëherë Kryesuesi i Kuvendit, konstaton se Kuvendi ka marrë Përfundim për përjashtimin e anëtarit të Kuvendit nga procedura e marrjes së vendimit për qështjen konkrete.

VII. PËRDORIMI I GJUHËVE NË PUNËN E KUVENDIT

Neni 19 – Përdorimi i gjuhëve

Përdorimi i gjuhëve zyrtare, në punën e Kuvendit, në hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe publikimin e akteve nga kompetenca e Kuvendit të Komunës do të bëhet në pajtim të dispozitave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

VIII. TRANSPARENCA E PUNËS NË MBLEDHJET E KUVENDIT

Neni 20 – Pjesëmarrja e publikut

20.1 Mbledhjet e Kuvendit janë të hapura për publikun, përveq në rastet kur për nga natyra e qështjeve me dispozita ligjore është paraparë shqyrtimi pa pjesëmarrjen e publikut.

20.2 Qytetarët, përfaqësuesit e shoqërisë civile, dhe përfaqësuesit e mediave kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të përcjellin punën e Kuvendit.

20.3 Në sallën për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit, për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe transparencën e punës, do të sigurohet një numër i ulëseve në hapësirën e caktuar.

IX. PËRCAKTIMI I RENDIT TË DITËS

Neni 21 - Përcaktimi i rendit të ditës dhe thirrja e mbledhjeve të Kuvendit

21.1 Pasi që Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës të konstatojnë se janë të përgatitura materialet për shqyrtim për punën e Kuvendit, përcaktojnë Rendin e ditës për mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës.

21.2 Kryesuesi i Kuvendit në bazë të përcaktimit të Rendit të ditës e thërret mbledhjen e Kuvendit të komunës.

Neni 22 - Përpilimi i listës së të ftuarve

Duke u bazuar në qështjet e përcaktuara në Rendin e ditës, përveç listës të anëtarëve të Kuvendit, hartohet listë e veçantë e të ftuarve.

Neni 23 - Dërgimi i ftesave dhe i materialeve

23.1 Shërbimi për punë Kuvendit në bazë të përcaktimit të Rendit të ditës përpilon ftesat për anëtarët e Kuvendit dhe të ftuarit tjerë .

23.2 Ftesat me materialet e përgatitura për mbledhjet e hapura të Kuvendit, në mënyrë të përshtatëshme do të iu dorëzohen anëtarëve të Kuvendit nëpërmjet shërbimit të ekspeditimit të shkresave ose nëpërmjet postes elektronike në afat prej shtatë (7) ditë pune para datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes.

23.3 Shërbimi për punë Kuvendit së bashku me Sektorin për marrëdhënie me publikun do të ndërmarrë veprimet e përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje përkitazi me njoftimet për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Komunës.

X. PUNA NË MBLEDHJET E KUVENDIT

Neni 24 - Kryesimi i mbledhjeve të Kuvendit

24.1 Mbledhjen e Kuvendit e kryeson Kryesuesi i Kuvendit.

24.2 Kryesuesi i Kuvendit, gjatë kryesimit të mbledhjeve të Kuvendit do të kujdeset:

- a) për funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës së Kuvendit;
- b) të merrë pjesë aktive në diskutim për qështjet nga kompetenca e Kuvendit;
- c) Kuvendi, në procedurën e vendosjes të miratimit të miratimit të bazuar në dispozita ligjore dhe Statutin e Komunës;
- d) të zbatohen drejtë dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe
- e) në pajtim të dispozitave të kësaj Rregulloreje të shqiptojë dhe të ndërmerrë masa disiplinore me rastin e prishjes së rendit të punës në mbledhjet e Kuvendit.

24.3 Anëtarët e Kuvendit duhet të angazhohen që të marrin pjesë aktivisht në mbledhjet e Kuvendit të Komunës duke u përgatitur për mbledhje dhe duke parashtruar mendimet e tyre lidhur me qështjet që shqyrtohen.

Neni 25 – Pjesëmarrja në mbledhje dhe diskutimet e Kryetarit të Komunës dhe anëtarëve të Ekzekutivit të Komunës

25.1 Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Ekzekutivit të Komunës marrin pjesë aktive në mbledhjet e Kuvendit dhe me diskutimet e tyre kontribuojnë në punën e Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e të gjitha qështjeve dhe miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës.

25.2 Në mbledhjet e Kuvendit mund të iu lejohej të diskutojnë edhe të ftuarve tjerë në rastet kur kjo i kontribuon shqyrtimit të qështjes së caktuar.

Neni 26 – Procesverbali dhe regjistrimi elektronik i mbledhjes

26.1 Për punën dhe ecurin e mbledhjes udhëheqet Procesverbal dhe bëhet regjistrimi elektronik i mbledhjes.

26.2 Procesverbali duhet të përmbajë emërtimin, radhën, vendin datën, orën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes.

26.3 Në procesverbal shënohen anëtarët e pranishëm të Kuvendit dhe anëtarët që mungojnë si dhe të ftuarit tjerë që janë të pranishëm në mbledhje dhe konstatimi për egzistimin e kuorumit për mbajtjen e mbledhjes.

26.4 Procesverbali duhet të përmbajë ecurinë e mbledhjes, pikat e aprovuara të rendit të ditës, pyetjet e anëtarëve të Kuvendit dhe përgjegjet në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit, përmbajtja e shkurtër e diskutimeve lidhur me pikat e rendit të ditës, propozimet e parashtruara, procedura e votimit dhe emërtimet e akteve të miratuara.

Neni 27 - Vërtetimi i Kuorumit

27.1 Në kohën e përcaktuar për fillimin e mbledhjes, procesmbajtësi në kërkesë të Kryesuesit të Kuvendit bënë thirrjen e anëtarëve të Kuvendit për vërtetimin e kuorumit për mbajtjen e mbledhjes dhe evidencon anëtarët e pranishëm dhe ata të cilët mungojnë.

27.2 Në bazë të rezultateve të evidencimit të prezencës, procesmbajtësi e informon Kryesuesin e Kuvendit, konform dispozitave të nenit 8 të kësaj rregulloreje, se a prezenton numër i mjaftueshëm i anëtarëve për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit.

Neni 28 - Hapja e mbledhjes dhe propozimi i rendit të ditës

28.1 Kryesuesi i Kuvendit, e hap mbledhjen e Kuvendit duke përshëndetur të pranishmit dhe e informon Kuvendin mbi numrin e anëtarëve të pranishëm dhe të atyre që mungojnë duke konstatuar se ekziston kuorumi i nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit.

28.2 Në vazhdim, Kryesuesi i Kuvendit, propozon rendin e ditës ashtu si është theksuar në ftesën e dërguar me material anëtarëve të Kuvendit.

28.3 Kryesuesi i Kuvendit, i njofton anëtarët e Kuvendit për propozimet eventuale të parashtruara me shkrim për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës.

28.4 Në vazhdim, Kryesuesi i Kuvendit, pyet anëtarët e Kuvendit, a kanë ndonjë propozim për plotësimin e rendit të ditës që ka të bëjë me çështjet urgjente me rëndësi publike, si dhe ndonjë propozim për heqjen e ndonjë pike të rendit të ditës.

28.5 Propozimet e parashtruara sipas par. 27.3 duhet të përmbajnë arsyetimin, ndërsa propozimet e parashtruara gjatë mbledhjes sipas par. 27.4 duhet të arsyetohen me gojë në kohëzgjatje jo më shumë se 3 minuta.

28.6 Kryesuesi i Kuvendit, pas propozimeve për shtimin ose heqjen e ndonjë pike të rendit të ditës, i vë në votim propozimet sipas radhës që janë parashtruar. Nga rezultatet e votimit konstaton shtimin apo heqjen e ndonjë pike të rendit të ditës.

28.7 Në vazhdim, Kryesuesi i Kuvendit, e vë në votim rendin e ditës të propozuar sipas ftesës me ndryshimet dhe plotësimet eventuale sipas procedurës së zbatuar sipas par. 27.6 të këtij neni. Nëse për propozimin e rendit të ditës kanë votuar “për” më shumë se gjysma e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në mbledhje, konstaton miratimin e rendit të ditës.

Neni 29 - Parashtrimi i pyetjeve dhe dhënia e përgjigjeve në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit

29.1 Pas aprovimit të rendit të ditës, anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë të parashtrojnë pyetje dhe të kërkojnë informacione nga Kryetari i Komunës dhe nga drejtorët e drejtorateve të Administratës Komunale përkitazi me çështjet e ndryshme nga kompetenca e Komunës.

29.2 Anëtarët e Kuvendit poashtu kanë të drejtë të ngrisin çështjen në Kuvend, në rastet kur sipas kërkesave të tyre të parashtruara me shkrim, nuk kanë marrë përgjigje

me shkriin nga organet kompetente të Komunës ose nuk janë të kënaqur me përgjigjen e dhënë.

29.3 Anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë të parashtrojnë më së shumti 2 pyetje dhe koha e diskutimit për parashtrimin e një pyetjeje nuk mund të zgjasë më tepër se 2 minuta.

29.4 Kryesuesi i Kuvendit, nuk do të hap diskutimin lidhur me pyetjet e parashtruara, por pas përfundimit të pyetjeve, do të kërkojë nga Kryetari i Komunës dhe nga drejtorët e drejtorateve të Administratës Komunale dhënien e përgjigjeve sipas radhës së pyetjeve të parashtruara. Përgjigja në pyetjen e parashtruar nuk mund të zgjasë më tepër se 5 minuta.

29.5 Kryesuesi i Kuvendit, pas dhënies së përgjegjes për pyetjen e parashtruar, mund të lejoj parashtruesin e pyetjes, lidhur me pyetjen të bëjë një pyetje shtesë në kohëzgjatje prej më së shumti dy minuta, ndërsa dhënia e përgjegjes nuk mund të zgjasë më tepër se pesë (5) minuta.

29.6 Në rastet kur për ndonjë pyetje nuk mund të ipet menjëherë përgjigja me gojë, përgjigja parashtruesit të pyetjes do ti ipet me shkrim më së largu deri në mbledhjen e ardhëshme të Kuvendit.

Neni 30 - Puna sipas rendit të ditës

30.1 Pas përfundimit të parashtrimit të pyetjeve dhe përgjigjeve lidhur me pyetjet e parashtruara, Kuvendi në propozim të Kryesuesit do të vazhdojë punën sipas pikave të aprovuara të rendit të ditës.

30.2 Kuvendi gjatë shqyrtimit të pikave të rendit të ditës, do të respektojë të gjitha procedurat e parapara me dispozita ligjore dhe Statutin e Komunës për miratimin e akteve të caktuara nga kompetenca e Komunës.

30.3 Përkitazi me pikat e rendit të ditës, sipas së cilave propozues i aktit - materialit është Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit ia jep fjalën Kryetarit të Komunës ose sipas autorizimit të Kryetarit të Komunës, Drejtorit të drejtoratit të Administratës Komunale kompetent për çështjen e cila shqyrtohet.

30.4 Pas diskutimit të Kryetarit të Komunës, përkatësisht të Drejtorit të drejtoratit të Administratës Komunale kompetent për çështjen e cila shqyrtohet, Kryesuesi i Kuvendit e njofton Kuvendin përkitazi me rekomandimet lidhur me shqyrtimin e materialit nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe komiteteve tjera si dhe me vërejtjet eventuale dhe amendamentet e dërguara me shkrim përkitazi me aktin i cili shqyrtohet.

30.5 Në vazhdim, Kryesuesi i Kuvendit e hap diskutimin. Fillimisht fjalën ua jep kryetarëve të grupeve parlamentare, Kryesuesve të komiteteve të Kuvendit që e kanë shqyrtue materialin dhe mëpastaj anëtarëve të Kuvendit sipas radhës që paraqiten për diskutim.

30.6 Kryetarët e grupeve parlamentare dhe anëtarët e Kuvendit mund të diskutojnë më së shumti dy herë për të njëjtën pikë të rendit të ditës, duke mos llogaritur të drejtën sipas rasteve kur mund të paraqitet replika.

30.7 Koha e diskutimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, për të njëjtën pikë të rendit të ditës, mund të zgjasë më së shumti 10 minuta, ndërsa e anëtarëve të Kuvendit më së shumti 5 minuta.

30.8 Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtori i Drejtoratit të Administratës Komunale kompetent për çështjen e cila shqyrtohet, gjatë zhvillimit të debatit dhe pyetjeve të parashtruara mund të jap sqarime plotësuese për çështjen e propozuar.

30.9 Në vazhdim, Kryesuesi i Kuvendit, pas përfundimit të debatit, do të propozoj të votohet për aktin përkatësisht çështjen e shqyrtimit. Fillimisht do të votohet për amendamentet e dërguara me shkrim, mëpastaj për propozimet e kryetarëve të grupeve parlamentare dhe propozimet e anëtarëve të Kuvendit sipas radhës që janë parashtruar. Mëpastaj do të votohet për aktin në tërësi bashkë me amandanet dhe propozimet e miratuara.

30.10 Procedura e votimit do të bëhet konform dispozitave të nenit 9 të kësaj rregulloreje. Anëtarët e Kuvendit sipas propozimit për mënyrën e vendosjes për çështjen e shqyrtuar, në propozim të Kryesuesit të Kuvendit, votojnë me vota të hapura me ngritjen e dorës, “për” propozimin ose “kundër” propozimit, përkatësisht mund të abstenojnë në procedurën e votimit.

30.11 Përkitazi me çështjen e shqyrtuar, në propozim të Kryesuesit të Kuvendit, me votim, Kuvendi mund të vendosë:

- a) të miratojë aktin;
- b) të refuzojë miratimin e aktit dhe
- c) të kërkojë që propozuesi të ndryshoj, harmonizoj ose të përmirësojë aktin.

30.12 Përkitazi me projektet e akteve, për të cilat sipas procedurës së përcaktuar me ligj kërkohet konsultimi i publikut, në propozim të Kryesuesit të Kuvendit, pas votimit, Kuvendi për Projektin e aktit të miratuar do të marrë vendim për konsultimin e publikut.

XI. RENDI DHE SJELLJA GJATË PUNËS SË KUVENDIT

Neni 31 - Përgatitjet paraprake për punën e Kuvendit

Departamenti i Administratës – Sektori për punë të kuvendit dhe Sektori për mirëmbajtje dhe operim, për datën e caktuar për mbajtjen e mbledhjes do të kryejnë përgatitjet e nevojshme administrativo – teknike që kanë të bëjnë :

- përgatitja e sallës për mbajtjen e mbledhjes,
- përgatitja e listave të prezencës dhe punëve administrativo teknike për udhëheqjen e Procesverbalit,
- përgatitjet për sigurimin e përkthimit të diskutimeve dhe të regjistrimit elektronik të

ecurisë së mbledhjes.

Neni 32 - Rregulli dhe sjellja në Kuvend

32.1 Të gjithë pjesëmarrësit në mbledhjen e Kuvendit kanë obligim për mbajtjen e rregullit, në mënyrë që puna e Kuvendit të zhvillohet në kushte normale.

32.2 Kryesuesi i kuvendit gjatë udhëheqjes së mbledhjes do të kujdeset që puna e Kuvendit të zhvillohet në kushte normale për debatim dhe vendosje meritore sipas pikave të aprovuara të rendit të ditës.

32.3 Pasi që Kryesuesi i kuvendit, të konstatoj fillimin e punës së mbledhjes së Kuvendit, të gjitha diskutimet gjatë debatimit në mbledhje do të bëhen me dhënien e fjalës nga Kryesuesi i kuvendit, sipas procedurës, radhës dhe kohëzgjatjes të përcaktuar me dispozitat e kësaj rregulloreje.

32.4 Diskutimet pa marrjen e fjalës nga Kryesuesi i kuvendit, nuk janë të lejuara, paraqesin shkelje të rregullave të punës së Kuvendit dhe nuk do të evidencohen në procesverbal.

32.5 Anëtarët e Kuvendit dhe pjesëmarrësit tjerë nuk duhet të ndërpresin fjalën e Kryesuesit të Kuvendit dhe diskutuesve të tjerë.

32.6 Gjatë debatit, pjesëmarrësit në diskutim, duhet të flasin për qështjet të cilat janë temë e debatit të përcaktuara me rendin e ditës.

32.7 Përdorimi i fjalëve jo të hijëshme, fyerjet, përhapja e informacioneve që cenojnë jetën private, ndërmarrja e sulmeve fizike dhe sjelljeve tjera me të cilat prishet rendi dhe çrregullohet puna normale e Kuvendit, paraqesin veprime jo të lejuara për të cilat në pajtim të dispozitave të kësaj rregulloreje parashihet shqiptimi i masave disiplinore.

Neni 33 - Masat disiplinore

33.1 Për mosrespektimin e rregullave të punës dhe rendit në kuvend të parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje, do të shqiptohen masat disiplinore.

33.2 Masat disiplinore i shqipton Kryesuesi i Kuvendit.

33.3 Masat disiplinore që zbatohen ndaj anëtarëve të Kuvendit janë:

- a) tërheqje vëmendjeje;
- b) vërejtje;
- c) Marrja e fjalës, dhe
- d) përjashtim nga mbledhja e kuvendit.

Neni 34 - Masa disiplinore tërheqje vëmendjeje

Kjo masë do të shqiptohet ndaj anëtarit të Kuvendit, në rastet në vijim :

- a) ndërpret Kryesuesin e Kuvendit dhe diskutuesit tjerë gjatë diskutimit;
- b) fillon të diskutoj pa marrjen e fjalës nga Kryesuesi i Kuvendit;
- c) vazhdon diskutimin jashtë kohës së paraparë për diskutim dhe
- d) pa arsye del nga salla gjatë kohës së mbajtjes së mbledhjes.

Neni 35 - Masa disiplinore vërejtje

Kjo masë do të shqiptohet ndaj anëtarit të Kuvendit dhe do të evidencohet në procesverbal, në rastet në vijim :

- a) përkundër masës së shqiptuar tërheqje vëmendjeje e përsëritë veprimin e paraparë në nenin 33 të kësaj Rregulloreje;
- b) duke ndërprerë Kryesuesin e Kuvendit dhe diskutuesit tjerë gjatë diskutimit, nga vendi përdorë fjalë jo të hijshme;
- c) gjatë diskutimit përdorë fjalë jo të hijshme, fyerje dhe përhapë informacioneve që cenojnë jetën private të individit;

Neni 36 - Masa disiplinore marrja e fjalës

Kjo masë do të shqiptohet ndaj anëtarit të Kuvendit dhe do të evidencohet në procesverbal, në rastet në vijim :

- a) pas shqiptimit të vërejtjes nga neni paraprak vazhdon të përsërisë veprimet që kanë ndikuar në shqiptimin e masës disiplinore; dhe
- b) kur pas tërheqjes së vëmendjes dhe vërejtjes vazhdon të diskutojë jashtë kohës së paraparë për diskutim dhe jashtë pikës që është temë diskutimi.

Neni 36 – Procedura për anulimin e masës disiplinore

Në rastet kur anëtari i Kuvendit, ndaj të cilit është shqiptuar masa e paraparë në nenin 34 dhe 35 të kësaj rregulloreje, në të njëjtën mbledhje kërkon publikisht ndjesë për sjelljen e tij, masa e shqiptuar do të anulohet nga Kryesuesi i Kuvendit dhe konstatimi mbi anulimin do të shënohet në procesverbal.

Neni 37 - Masa disiplinore përjashtim nga mbledhja e kuvendit

37.1 Kur anëtari i Kuvendit, ndaj të cilit më parë është shqiptuar njëra nga masat disiplinore sipas neneve 34 dhe 35 të kësaj rregulloreje, vazhdon të përsërisë sjelljet dhe veprimet që kanë ndikuar për shqiptimin e masës, si dhe në rastet e përdorimit të dhunës fizike ndaj ndonjë pjesëmarrësi në mbledhjen e Kuvendit, me urdhër të Kryesuesit të mbledhjes, do të përjashtohet nga mbledhja e kuvendit për atë ditë dhe nuk do të ketë të drejtë në marrjen e kompensimit shtesë për pjesëmarrje në mbledhje.

37.2 Masa e shqiptuar nga neni paraprak do të evidencohet në procesverbal.

37.3 Në rast se anëtari, ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinore përjashtim nga mbledhja e kuvendit, nuk pranon të dalë nga salla ose më vonë tenton të marrë pjesë në mbledhje, kryesuesi përkohësisht e ndërpret mbledhjen dhe i jep porositë e nevojshme shërbimit të sigurisë për zbatimin e urdhërit të dhënë.

XII. SHTYRJA, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MBLEDHJES SË KUVENDIT

Neni 38 - Shtyerja e mbledhjes së Kuvendit

38.1 Mbledhja e caktuar e Kuvendit shtyhet kur paraqiten shkaqet të cilat e pamundësojnë mbajtjen e saj në ditën e caktuar.

38.2 Mbledhja e Kuvendit shtyhet edhe kur pas hapjes konstatohet se në mbledhje nuk marrin pjesë numër i mjaftueshëm i anëtarëve të Kuvendit për vendosje meritore.

38.3 Për shtyrjen e mbledhjes së Kuvendit vendos Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Neni 39 - Ndërprerja e mbledhjes së Kuvendit

39.1 Mbledhja e Kuvendit ndërpritet në rastet vijuese:

- a) me qëllim të pushimit gjatë mbledhjes, i cili nuk mund të zgjasë më tepër se gjysmë ore;
- b) kur gjatë mbledhjes numri i anëtarëve bie nën numrin e paraparë për mbajtjen e mbledhjes dhe vendosje meritore;
- c) kur për shkak të qëndrimit të gjatë në mbledhje, e njëjta nuk mund të kryhet atë ditë dhe
- d) kur vjen deri te prishja e rëndë e rregullit të punës, por që kryesuesi nuk është në gjendje që me masa disiplinore të parapara me këtë rregullore ta kthej punën në gjendje normale.

39.2 Mbledhja e ndërprerë vazhdohet me të njëjtin rend pune të nesërmen nëse nuk është ditë pushimi ose në ndonjë ditë tjetër brenda javës të caktuar nga Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 40 - Përfundimi i mbledhjes

Mbledhja e Kuvendit konsiderohet e përfunduar pas shqyrtimit dhe vendosjes sipas pikave të rendit të ditës.

XIII. PËRGATITJA DHE NËNSHKRIMI I AKTEVE TË MIRATUARA NGA KUVENDI

Neni 41 – Përgatitja e akteve të miratuara

Departamenti i Administratës – Sektori për punë të kuvendit, pas përfundimit të mbledhjes së Kuvendit, në afatin sa më të shkurtë, do të përgatisë aktet për nënshkrim dhe publikim në formën dhe përmbajtjen e aprovuar nga Kuvendi.

Neni 42 – Nënshkrimi i akteve të miratuara

42.1 Aktet e miratuara nga Kuvendi i nënshkruan Kryesuesi i Kuvendit.

42.2 Departamenti i Administratës – Sektori për punë të kuvendit, pas nënshkrimit të akteve nga Kryesuei i Kuvendit, në afatet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës, do të kryejë punët administrativo-teknike për dërgimin e akteve të miratuara Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe organeve kompetente të Komunës.

XIV. PUBLIKIMI I AKTEVE TË MIRATUARA NGA KUVENDI

Neni 43 – Publikimi i akteve

43.1 Aktet e miratuara nga Kuvendi do të publikohen në Webfaqen e Komunës dhe Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës, në pajtim me dispozitat e Statutit të Komunës.

43.2 Punët administrativo-teknike për publikimin e akteve të Kuvendit do ti kryejë Sektori për marrëdhënie me publikun.

XV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 44 – Procedura për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores së punës

44.1 Propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës mund ta iniciojë çdo grup parlamentar i Kuvendit si dhe së paku nga 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

44.2 Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores do të bëhen sipas procedurës të përcaktuar për miratimin e kësaj rregulloreje.

Neni 45 – Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës dhe Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës

INr. 020-733
Lipjan, më 20.11.08

KUVENDI I KOMUNËS - LIPJAN



KRYESUESI I KUVENDIT
Lulzim Rustemi

 16